



Primar / Doretuar Prilbjen / Prodoto Received / Delivered	26.06.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitca Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	4906/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.677/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.677/2023 të datës 27.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 23.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.677/2022 e datës 26.05.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. *Anulohet* Vendimi me numër protokoli 3025/02 i datës 26.05.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë si dhe Renditja Përfundimtare e Kandidateve e datës 16.05.2023.
- III. *Mbetet në fuqi* Konkursi për Ngritje (avancim) në detyrë me numër referencë RN00010807, për pozitën e punës Drejtor i Departamentit të Tregtisë, në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si dhe çdo veprim i pasuar deri në vlerësimin përfundimtar të kandidateve, *ndërsa çështja kthehet në rishqyrtim* në fazën e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- IV. *Obligohet* Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II dhe III të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi (tutje vetëm ankuesi), më datë 27.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 29.05.2023, për shkak të mos përmbylljes së procesit të rekrutimit ngritje (avancim) në detyrë për pozitën "Drejtor i Departamentit të Tregtisë" në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë si dhe vlerësim jo të korrekt nga Komisioni vlerësues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 12.05.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3861/2023 të datës 27.04.2023 të parashtruar nga ankuesi V.X në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër reference RN00010807 të shpallur nga MINT me datë 26.01.2023; Aplikacionin e kandidatit të datës 16.02.2023 së bashku me përgaditjet profesionale, përvojën e punës dhe trajnimet; Njoftimin lidhur me rezultatin e testimit me shkrim të dërguar me e-mail nga SIMBNJ për V.X me datë 20.03.2023; Njoftimin lidhur me rezultatin e jetëshkrimit të dërguar me e-mail nga SIMBNJ për V.X me datë 20.03.2023; Pasyqra e llogarisë së Trustit e kandidatit V.X e periudhës 01.08.2002-04.07.2018 me korrespondim prej 1-5 faqe; ID e punës e kandidatit ID e punës e kandidatit V.X; Certifikatë e marrëdhënies së punës mes Zyrës së Kryeministrit dhe V.X me nr.protokolli 787/2014 të datës 08.10.2014; Vërtetim i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe V.X me numër protokolli 85 të datës 06.04.2022; Kontratë e marrëdhënies së punës mes Ministrisë së Administratës Publike dhe V.X me numër protokolli 231 të datës 08.12.2010; Kontratë e marrëdhënies së punës mes Ministrisë së Administratës Publike dhe V.X me numër protokolli 153 të datës 14.05.2010; Akt emërim i lëshuar nga Ministria e Administratës Publike për V.X me numër protokolli 109 të datës 30.08.2019; Kontratë lidhur mes ReSPA dhe V.X e lidhur me datë 25.05.2017; Certifikatë me numër TPT02/09/2020 e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për V.X për periudhën 25.11.2019-20.06.2020; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për V.X me datë 30.10.2018; Certifikatë e lëshuar nga "European Union Kosovo" për për periudhën 25-27.04.2018; Certifikatë e lëshuar nga "IACA" për për periudhën 11-13.12.2017; Certifikatë e lëshuar nga "USAIDI" për V.X me datë 14.07.2017; Certifikatë e lëshuar nga "Ministry of Foreign Affairs of Turkey" për V.X me datë 14.10.2016; Certifikatë e lëshuar nga "USAIDI" për V.X në muajin Qershor 2017; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për V.X per periudhën 29-30.09.2015; Certifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për V.X për periudhën 02-03.02.2017; Certifikatë e lëshuar nga "U.S Embassy Pristina" për V.X për periudhën 02-04.06.2010; Certifikatë e lëshuar nga "USAIDI" për V.X periudhën Shtator 2006-Janar 2007; Certifikatë e lëshuar nga "Friedrich Nauman Stiftung" për V.X për periudhën 23-25.08.2006; Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X me datë 27.10.2022; Certifikatë e lëshuar nga "USAIDI" për V.X me datë 24.05.2008; Diplomë me numër 1011-1830/1 e lëshuar nga Universiteti i Evropës Jug-Lindore për V.X; Vendim me numër Ref.2/6-3432 i lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me datë 19.07.2021; Diplomë me numër 1469 të

lëshuar nga Universiteti i Prishtinës-Fakulteti Filozofik për V.X me datë 10.12.2010; Vërtetim i kopjës së origjinalit me LRP.nr.2919/2021 i datës 07.07.2021 për V.X; Kërkesë e dërguar me e-mail nga V.X L.H, G.S dhe Z.K me datë 03.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për V.R me datë 31.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga A.D për V.X me datë 13.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për R.B, A.D, L.H, Z.K dhe G.F me datë 13.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga R.B për A.D, L.H, Z.K dhe G.F me datë 07.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga A.D për L.H, Z.K dhe G.S me datë 07.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për A.D, V.R-V dhe B.B me datë 07.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.R-V për V.X me datë 27.03.2023; Kërkesë për qasje në dokumente publike e dërguar me e-mail nga V.X për D.B, ZKP.MINT, B.B dhe V.R-V me datë 04.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga A.D për V.X me datë 22.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për A.D, V.R-K dhe B.B me datë 21.03.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga SIMBNJ për V.S me datë 20.03.2023; Kërkesë e dërguar me e-mail nga V.X për L.H, G.S dhe Z.K me datë 14.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga 13.04.2023; Njoftim i dërguar me e-mail nga V.X për R.B, A.D, L.H, Z.K dhe G.S me datë 07.04.2023; Kërkesën për ndërmarrjen e veprimeve ligjore për përmbyllje të procesit rekrutues të parashtruar nga ankuesi V.X për Kryetaren e Komisionit të vlerësimit për ngritjen në detyrë me datë 14.04.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 3999/2023 të datës 02.05.2023 të dërguar nga KPMSHCK për MINT; Përgjigjen në kërkesë me numër protokoll 2576/2023 të datës 12.05.2023 të dërguar nga MINT për KPMSHCK; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe të nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X me datë 12.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe të nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X me datë 28.01.2022; Vërtetim me numër protokoll 87/2022 i datës 27.05.2022 i lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme për V.X; Certifikatë mbi dënimet penale e datës 16.02.2023 e lëshuar nga Sistemi Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Lista e aplikantëve për konkursin me numër reference RN00010807; Vendim me numër protokoll 1244/02 i datës 14.03.2023 i lëshuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për themelimin e Komisionit të Vlerësimit për Ngritje në Detyrë; Zarfim me numër 2576/03 i datës 12.05.2023;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tuje MINT), me datë 26.01.2023 ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ) Konkursin me për Ngritje (avancim) në Detyrë, numër reference RN00010807, për pozitën e punës "Drejtor i Departamentit të Tregtisë", e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 10.02.2023 deri me 17.02.2023, ndërsa sipas listës së aplikantëve rezultoi se numri i kandidatëve aplikues ka qenë dy, me ç'rast procedura ka vazhduar vetëm me një kandidat në këtë rast ankuesin, si kandidat i vetëm që ka plotësuar kriteret e pozitës së shpallur.

Me tej nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit përkatësisht vlerësimit me shkrim (testit) si dhe intervistës me gojë të mbajtur me datë 30.03.2023, mirëpo Komisioni për vlerësimin për ngritjen në detyrë i themeluar me Vendimin Nr.Ref.02/72 të datës 14.03.2023 të Sekretar i Përgjithshëm të MINT, nuk kishte përfunduar procesin e vlerësimit dhe së ankuesi nuk ishte njoftuar me rezultatin e vlerësimit.

Pasi që nuk ka pranuar ndonjë njoftim lidhur me rezultatet e vlerësimit, ankuesi me datë 27.04.2023 parashtron ankesë në Këshill për shkak të mos përmbylljes së procesit të procesit rekrutues.

Rrjedhimisht, vetëm pas parashtrimit të ankesës në Këshill, Komisioni i vlerësimit ka përfunduar procesin e vlerësimit, duke e njoftuar ankuesin më datë 17.05.2023, së i njëjti sipas vlerësimit të Komisionit Vlerësues ka arritur vetëm 57.33 pikë, të pamjaftueshme për t'u emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit të Tregtisë, dhe është udhëzuar për të drejtën e ankesën në Këshill. Ankuesi konform këtij udhëzimi juridik, parashtron ankesë në Komisionin për Vlerësim, i cili me Vendimin numër protkoll 3025/02 të datës 26.05.2023 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit, me arsyetimin së Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në pajtim me dispozitat e Rregullore Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil. Pas këtyre veprime procedurale ankuesi ka bërë plotësimin e ankesës të datës 27.04.2023, me pretendimin së vlerësimi i ankuesit nuk është real, ngase sipas ankuesit i njëjti kishte dhënë përgjigje të detajuar në intervistën me gojë dhe së Komisioni nuk ka bërë vlerësim e drejtë të jetëshkrimit (CV).

Sipas renditjes përfundimtare të kandidateve të datës 16.05.2023 të Komisionit për Ngritje në Detyrë, Kolegji ka gjetur së në testimin me shkrim ankuesi është vlerësuar me 51 pikë prej 70 pikëve, ndërsa në vlerësimin e jetëshkrimit është vlerësuar me 5.33 pikë nga 20 pikët e mundshme, kurse në intervistën me gojë është vlerësuar me 1 pikë nga 10 pikët e mundshme.

Duke u bazuar në shpalljen e Konkursit më numër reference RN0001087, për pozitën punës *Drejtor i Departamentit të Tregtisë*, si kërkesat e përgjithshme formale janë vendosur: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 4 vite të studimeve :Fakulteti Ekonomik, Juridik. Marrëdhënie Ndërkombëtare , përvoja e punës e kërkuar: së paku gjashtë (6) vite përvojë pune profesionale, përfshirë së paku tri(3) vite në pozita drejtuese.*

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e ngritjes në detyrë përkatësisht nenit 39 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: *1. Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë. 2. Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji. 3. Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë. 4. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë nen, për procedurën e ngritjes në detyrë zbatohen dispozitat e paragrafëve 4 deri 9 të nenit 34 të këtij ligji."*

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenin 52 ku parashihet se *"1.Në rastet kur një pozitë e lirë në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, pozita hapet për të plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë. 2.Ngritja në detyrë është procedurë konkurruese. Konkurimi organizohet për një pozitë të lirë. 3.Konkurimi për ngritjen në detyrë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të një kategorie më të ulët të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil dhe neni 53 1.Për*

të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Kushtet për ngritjen në detyrë janë: 2.1. nëpunësi të ketë të paktën tre (3) vjet pune në pozitën e një kategorie më të ulët. Në rastin e procedurës për ngritjen në detyrë në një pozitë të kategorisë të ulët drejtuese, periudha e punës provuese llogaritet si kohë e përvojës në punë; 2.2. nëpunësi të mos jetë ndëshkuar me masën disiplinore të parashikuar nga nënparagrafi 1.3 i neni 47 të Ligjit, që nuk është shuar ende; 2.3. nëpunësi të jetë vlerësuar të paktën "mire" për rezultatet individuale në punë, gjatë dy (2) viteve të fundit para konkurrimit për ngritje në detyrë. 3.Në rastin e vlerësimit të rezultateve individuale "shumë mirë" apo shkëlqyeshëm për dy vitet e fundit, nëpunësi mund të aplikojë për ngritje në detyrë edhe nëse ka vetëm dy (2) vite punë në kategorinë më të ulët. 4.Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për ngritjen në detyrë.

Në kuptim të kuadrit ligjor si lartë si dhe duke u bazuar në provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, Kolegji ka konstatuar së ndërlidhur me procesin e vlerësimit të ankuesit si kandidat i vetëm në procedurën e ngritjes në detyrë për pozitën e punës Drejtor i Departamentit të Tregtisë në MINT, ekziston vetëm shkresa me emërtimin "Renditja përfundimtare e kandidatëve ",e datës 16.05.2023, e cila përmban vetëm një listë me pikët e përgjithshme të kandidatit, duke mos përmbajtur ndonjë shkresë sqaruuese lidhur me rrjedhën e kësaj procedure dhe me theks të veçantë formularët e vlerësimit nga çdo anëtar i Komisionit të Vlerësimit. Andaj, në mungesë të këtyre fakteve, Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni i Vlerësimit për Ngritje në Detyrë i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka vepruar në kundërshtim me ligjin material gjegjësisht nenin 48 ndërlidhur me nenin 63 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: Çdo anëtarë i KVLBK jep pikët e tij në mënyrë individuale pas vlerësimit sipas nenit 47 të kësaj rregullore. Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit.

Përkitazi me pretendimin ankimor së Komisioni Vlerësues nuk ka bërë vlerësim të drejt të jetëshkrimit të ankuesit, Kolegji ju referua nenit 61 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës më të cilën është përcaktuar se: 1. Pas testimit me shkrim, KVND, kryen vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve. 2. Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe rezultateve të arsimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve dhe kualifikimeve domethënëse për punën 3. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin është deri njëzet (20) pikë, si vijon: 3.1. tetë (8) pikë për cilësinë dhe nivelin e arsimit; 3.2. shtatë (7) pikë për përvojën domethënëse në punë, dhe 3.3. pesë (5) pikë për trajnimet dhe kualifikimin. 4. Secili nga anëtarët e KVND, bën vlerësimin e detajuar për secilin prej faktorëve të përcaktuar në paragrafin. 3 të këtij neni. Vlerësimi është mesatarja vlerësimeve e të gjithë anëtarëve, rrjedhimisht Kolegji ka shqyrtuar dosjen personale të ankuesit të dorëzuar me rastin e aplikimit nga dhe ka vlerësuar së Komisioni Vlerësues ka bërë nënvlerësim të jetëshkrimit të ankuesit duke e notuar të njëjtin me 5.33 pikë, sepse ankuesi posedon arsimin e kërkuar, ka përvojë punë domethënëse të punës dhe së ka të përfunduar trajnime profesionale dhe si njëjti posedon certifikatë të trajnerit në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Lidhur me vlerësimin e ankuesit në intervistën me gojë ku ankuesi ishte vlerësuar me vetëm 1 pikë nga 10 pikët e mundshme siç përcaktohet me nenin 62 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji bazuar në shkresat e

lëndës nuk ka arritur të gjej ndonjë shkresë në të cilën është evidentuar rrjedha e intervistës gjegjësisht cilat kanë qenë pyetjet që i janë bërë ankuesit dhe cilat janë përgjigjet e dhëna nga ankuesi dhe po ashtu si është vlerësuar ankuesi nga anëtarët e KVND veç e veç.

Për me tepër, Kolegji nga shkresat e kësaj çështje ka gjetur së nga data 30.03.2023 kur ishte mbajtur intervista me gojë deri me datë 16.05.2023 Komisioni i Vlerësues nuk kishte përfunduar procedurën e avancimit për pozitën Drejtor i Tregtisë, rrjedhimisht disa nga anëtarët nuk kishin përfunduar vlerësimin përkundër kërkesave të vazhdueshme të Njesisë së Burimeve Njerëzore të MINT-it dhe se me asnjë shkresë ky Komision nuk kishte arsyetuar shtyrjen e përfundimit të procedurës gjegjësisht vlerësimit të kandidatit pjesëmarrës, në këtë rast ankuesit.

Andaj, siç u përcaktua më lart, rrjedhimisht duke qenë procedura e ngritjes në detyrë për pozitën e punës "Drejtor i Departamentit të Tregtisë", është përcjell me shkelje ligjore, Kolegji i Këshillit vlerëson së pretendimet ankimore të ankuesit janë të drejta dhe të bazuar, ndërsa duke qenë së akti i shpalljes së konkursit si dhe veprimet e ndërmarra administrative deri në vlerësim përfundimtar të ankuesit nuk janë të përfshira me të meta procedurale dhe materiale, Kolegji i Këshillit vendosi që të anulohen të gjitha veprimet administrative të përcaktuara si në dispozitiv të këtij vendimi, me detyrimin që Komisioni i Vlerësimit në ri procedurë të merr parasysh të gjeturat dhe pikëpamjet juridike të Kolegjit të dhëna sipas këtij vendimi.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.677/2023;

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.